

Hazir Mehmeti,
Nexhmije Thaçi-Mehmetaj,
Rifat Hamiti

NJË BOTË PËR TË GJITHË

Fletore tematike
për nivelin e tretë

dukgjini

MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS
DHE E TEKNOLOGJISË E KOSOVËS

TEKSTE MËSIMORE PËR SHKOLLËN SHQIPE
TË MËSIMIT PLOTËSUES NË DIASPORË


- Autorë/e:
Besa Luzha, Hazir Mehmeti, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti, Nexhat Maloku,
Nexhmije Thaçi-Mehmetaj, Rifat Hamiti, Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj, Xhevat Syla.
- Hartues/e të këtij teksti: Hazir Mehmeti, Nexhmije Thaçi-Mehmetaj, Rifat Hamiti
- Koordinatorë: Arif Demolli, Basil Schader, Nuhi Gashi
- Projekti është mbështetur nga Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut (Instituti IPE – International Projects in Education) dhe Fondi i Llotarisë i Cyrihut (Lotteriefonds des Kantons Zürich) në Zvicër.



**LOTTERIEFONDS
KANTON ZÜRICH**

PËRMBAJTJA

1. Daullet e paqes.....	5
2. Ëndrra e Ilirit	7
3. Një festë e përbashkët shumëkulturore	9
4. Miqësia e re	12
5. Në festival	15
6. Bie shi	18
7. Në restorant	22
8. Çka ka veshur ai/ajo?.....	25
9. Përshtypje nga shëtitja	28
10. Mjedisi na takon të gjithëve	31
11. Kujdesi ndaj shëndetit.....	33
12. Sporti, kalitja dhe shoqëria	35
13. Si udhëtuani perimet	37
14. Kujdesi ndaj gjallesave	39
15. Shoqet	41
16. Europa, kontinenti ynë i përbashkët	43
17. Liria dhe të drejtat për të gjithë	45
18. Arsimi për të gjithë	47
19. Familja e Teonës	49
20. Kush ishte Nëna Tereze.....	51



DAULLET E PAQES

Vështroni fotografinë dhe thoni çka ju bën përshtypje? Çka dini për këtë ngjarje?



Dita Botërore e Poezisë për Fëmijë është festuar edhe në Tiranë. Fëmijët e shkollës "Viktor Hygo" u kanë rënë daulleve të paqes në sheshin "Nëna Tereze" dhe kanë shfaqur një program me poezi. Përmes tyre përcjellin mesazhet për një botë pa dhimbje, ku çdo kush duhet të ketë lirinë, të drejtat dhe jetën e tij.

Besniku: Nesër do të marrim pjesë në festën «Daullet e Paqes».

Do të nisemi herët, që të arrijmë atje në orën dhjetë paradite.

Mendoj se kjo është ora më e përshtatshme për të arritur në sheshin "Pheniks". Si thoni ju?

Kedini: Mirë, Besnik, ashtu do të bëjmë.

Arzuja: Me çka do të udhëtojmë deri te sheshi?

Besniku: Mendoj të marrim autobusin e orës tetë, apo dëshironi të shkojmë me tramvaj?

Kedini: Jo, me tramvaj udhëtojnë shumë njerëz. Më mirë marrim autobusin.

Emanuela: Do të jem e lumtur kur t'i bie daulles, këtij instrumenti mijërvjeçar, i bukur e i njobur në Kinën Jugore dhe në Laos. Por, sa di unë, është edhe simbol i veprës së shkrimitarit të njobur Ismail Kadare, e njobur në frëngjisht si "Daullet e shiut". *Të nesërmen në orën e caktuar trembdhjetëvjeçarët arritën në vendin e paraparë. Ata i drejtohen hyrjes, ku i pret presidenti i Shtëpisë Ndërkombëtare të Poezisë për Fëmijë.*

Trembdhjetëvjeçarët: Mirëdita, zotëri!

Zoti Simon: Të dashur miq, mirë se keni ardhur në festën tonë! Në fillim unë po ju them vetëm disa gjëra për historinë e kësaj dite. Rituali "Daullet e Paqes" ka lindur nga "Dita Botërore e Poezisë për Fëmijë", e cila bëhet më 21 mars në Bruksel, mu në zemër të Evropës. Çdo vit ftohen fëmijët nga mbarë bota të krijojnë poezi për paqen. Ata përmes poezisë sjellin zërin dhe tingullin e paqes. Motoja e poezive të përcjella nga vetë fëmijët

ishte «*Shtrije dorën dhe jo grushtin*». Një herë në vit, në orën 11:30, ftohen fëmijët nën moshën 13 vjeç anë e kënd botës t'u bien daulleve për paqe në shenjë simbolike. Vitin e kaluar më shumë se 1 000 000 fëmijë në Evropë dhe Afrikë u ranë daulleve të paqes në sheshet qendrore të qyteteve dhe të fshatrave të tyre.

Besniku: Atëherë, ja teksti i poezisë sime: Shoh një shkollë pa dhunë.

Kedini: Vëllazërim i të gjitha ngjyrave.

Arzuja: Ne i këndojmë paqes.

Emanuela: Bota është shtëpia jonë.

Zoti Simon: Mirë. Ejani, zini vendet!



1. Përgjigjjeni pyetjeve (me gojë ose me shkrim në fletoren tuaj)!

- Kur donte të nisej Besniku dhe pse në atë orë?
- Me se do të shkojnë në sheshin «Pheniks» dhe pse jo me tramvaj?
- Çka u thotë zoti Simon nxënësve?
- Trego çdo gjë që e di tash për festën «Daullet e Paqes»!
- Kur dhe ku bëhet «Dita Botërore e Poezisë për Fëmijë» dhe çka bëjnë fëmijët me atë rast?

2. Çka kupton me shprehjen «*Shtrije dorën dhe jo grushtin*»?

3. Përktheje shprehjen «*Shtrije dorën dhe jo grushtin*» në gjuhën e vendit ku jeton!

3. Shkruaj edhe ti një mesazh për paqen.

3. Lexo dhe lidh emrin me vargun e saktë të poezisë:

Besniku: Ne i këndojmë paqes.

Kedini : Bota është shtëpia jonë.

Arzuja: Vëllazërim i të gjitha ngjyrave.

Emanuela: Shoh një shkollë pa dhunë.

ËNDRRA E ILIRIT

- Zamira:** Ilir, kush është djali me të cilin të shoh shpesh? A është në klasën tënde?
- Iliri:** Nuk e di për kë më pyet,
- Zamira:** Një djalë zeshkan, syzi e me vetulla të trasha dhe flokë të drejtë.
- Iliri:** S'di pér kë e ke fjalën.
- Zamira:** Si nuk e di? Ai djali me qafë të gjatë dhe me krahërin e gjerë.
- Iliri:** E di, është Begoja! Po, ai çdo të hënë më pret përpara shkollës dhe shkojmë bashkë në pishinë. Me ne vijnë edhe Liria dhe Kujtesa. Ai është sportist i dalluar.
- Zamira:** Me çfarë sporti merret ai?
- Iliri:** Ai bën not dhe është kampion në garat e vravimit. Është i gjithanshëm. Vitin e kaluar ka shpëtuar një fëmijë gjashtëvjeçar nga mbytja në ujë. Merre me mend, ai ka rrezikuar jetën e vet pér ta shpëtuar një jetë tjetër. Me këtë rast Fondacioni i Bëmirësisë “Shpëtimi” i Prizrenit i dha mirënjohje. Ti, Zamira, mos ke simpati pér të?
- Zamira:** Jo, nuk kam simpati! Të pyeta kot.
- Iliri :** Shoku im merret edhe me peshkim. Dje më çoi buzë Lumbardhit, atje ku uji është i qetë dhe i cekët pér të peshkuar. I hoqëm këpucët, i përvolëm pantallonat dhe ai filloj të më tregonte se si peshkonte.
- Zamira:** Çka të dallon ty nga Begoja?
- Iliri:** Zamira, të premteve unë shkoj në mundje, por atij nuk i pëlqen mundja. Të shtunave shkoj në kinema. Shoku im nuk vjen, sepse thotë se nuk i pëlqen filmi. Ai nuk vjen as në shkollë, madje e ka ndërëprerë mësimin. Një ditë në bankë e gjetëm një copë letër të shkruar prej tij:
- Shkollën po e lë. Nuk më vihet, sepse më ngacmojnë shokët dhe shoqet e klasës. Më shajnë, më thonë ‘magjup’ e unë nuk mund t’i duroj. Tash unë do të mbledh kanaçe dhe... Kaq.*

Begoja

Ky shkrim të gjithëve na preku në zemër. Në klasë ra heshtja. Arsimtari mori shkumësin dhe shkroi me shkronja të mëdha: STOP RACIZMIT! I kërkua atij të kthehet përsëri në klasë. Por as që i lëkundej mendja. E pat vështirë të integrohej në shoqërinë tonë. Ishte i vetmi rom në klasë dhe ashtu mbeti. Për fat të keq, shoku im nuk e di mirë gjuhën e tij rome e as shqipen. Ëndrra ime është që fëmijët romë të mos mbeten ashtu të ndarë e të vetmuar si lypsa të rrugëve. Ndarja është e keqe pér të gjithë!

Zamira: Ashtu është, Ilir. Të këqijat të gjithë duhet t’i dënojmë.

1. Lexoje tekstin me vëmendje dhe lidhi fjalitë!

1. Kush është djali me të cilin të shoh shpesh?

të trasha, që i ka flokët e drejtë

2. Ai djalë zeshkan syzi e me vetulla

A është në klasën tënde?

3. Me çfarë sporti merret ai?

djali gjashtëvjeçar nga mbytja në ujë.

4. Vitin e kaluar ka shpëtuar jetën e një

Ai bën not, ski, xhudo.

5. Ti, Zamira. . . mos ke simpati për të?

mbetën ashtu të ndarë e të vetmuar.

6. Të premteve unë shkoj në mundje, por

Jo, nuk kam simpati!

7. Ëndrra ime është që fëmijët romë të mos

atij nuk i pëlqen mundja.

2. Për secilën fjali krijoni nga një pyetje!

1. Zamira e sheh Ilirin shpesh me një djalë zeshkan. (Me kë e sheh Zamira Ilirin?)

2. Ai ka qafë të gjatë, flokë të drejtë dhe kraharor të gjerë. _____

3. Ai është Begoja, sportist i dalluar. _____

4. Çdo të hënë e pret Ilirin përparrë shkollës. _____

5. Begoja nuk e di mirë gjuhën shqipe. _____

3. Shikoni këtë figurë simbolike dhe shkruani disa fjali për të!



4. Përgjigjju pyetjeve në fletoren tënde!

a) Kush banon në Kosovë përvèç shqiptarëve? Cilat komunitete dhe pakica?

b) Si ishte populli i Kosovës në të kaluarën? I lirë, i lumtur, i shtypur, i keqtrajtuar? Pse?

c) Si është sot Kosova? E lirë, e pavarur, e shtypur? Cilat janë problemet e saj më të mëdha?

ç) Si ndjehen pakicat në Kosovë? Të lira, të lumtura, të frikësuara, të shtypura?

NJË FESTË E BUKUR SHUMËKULTURORE

Lagja numër nëntë është pjesë e madhe e qytetit të Parisit. Çdo familje është nga një vend i largët nga këtu. Të rinjtë Neto, Albani, Pablo, Jack, Annie, Mia janë miq të ngushtë. Ata kanë krijuar klubin "Përkrash njëri-tjetrit". Aty janë mbledhur të gjithë dhe bisedojnë.

Annie: Miq të respektuar! Për banorët e lagjes sonë shumëkulturore do të organizojmë një festë të bukur.

Mia: Ideja jote më pëlqen shumë.

Albani: Jack, më thuaj çfarë programi do të kemi ditën e shtunë?

Jack: Ne të rinjtë mund të tregojmë se nëpërmjet kulturës, traditës, gjuhës dhe prejardhjes sonë jemi kampionët më të mëdhenj të lirisë, bashkëjetesës dhe zemërgjerësisë mes kulturave.

Annie: Të hapim edhe një eksposítë me fotografi me pamje nga fshati e qyteti ynë.

Neto: Mirë. A të sjellim dhe dy-tre piktura të vjetra? Ndoshta mund t'i shesim. Me parat që do të fitojmë do të mund të bëjmë edhe ndonjë projekt tjetër.

Pablo: Sikur të paraqesim edhe nga një pikë muzikore në fund?

FTESË

DITËN E SHTUNË, MË DATË 23 DHJETOR, NË ORËN 15.00,

ME RASTIN E FILLIMIT TË PUSHIMEVE DIMËRORE,

TË RINJTË E LAGJES SË NËNTË ORGANIZOJNË

NJË FESTË SHUMËKULTURORE ME TITULL "LARG DHE AFËR".

JU FTOJMË TË MERRNI PJESË!

ADRESA: LAGJA NR. 9, PARIS, FRANCË

Programi:

- Eksposítë me fotografi nga vende të ndryshme të botës
- Muzikë në disa gjuhë

P. S. Në lagjen nr. 9 mund të vini me autobusin nr. 4, i cili niset nga posta kryesore në orën 14:30.

Bashkëmoshatarët dolën në skenë dhe përshëndetën me dorë banorët e lagjes që prisnin në sallë. Albani filloi: *Ishte viti 2004 kur lashë Korçën time. Erdha në vendin e shumë pëlqyer të çdo qytetari të vendeve të vogla, Parisin. Më pëlqeu Parisi. Ishte i bukur, gjithmonë për sytë e mi. Sonte kam gjetur rastin t'ju flas se si më 24 dhjetor në Shqipëri pothuajse të gjithë festojnë Këershëndellat. Shqiptarët janë shumë të gëzuar, myslimanët vijnë të festojnë së bashku me të krishterët. Me këtë rast shpërndajnë dhurata për të gjithë dhe thonë: Gëzuar për shumë mot Këershëndellat! Shumë shqiptarë të besimit të krishterë festojnë festat e ritit mysliman me fqinjët e tyre.*

Një djalë i ri dha një mendim vërtet të mrekullueshmëm. ”Sa me qejf do të shkoja në atë vend për të takuar njerëz bujarë e për t'u njohur me miq të rinj!” Albani befas e ndjeu vetën tepër të lumtur. As vetë nuk e dinte përsë i erdhi kjo valë gëzimi e papritur.



1. Shikoni fotografinë dhe përshkruani tregimin me pak fjali!

2. Lexoni fjalitë dhe anash shkruani + (e saktë) ose – (e pa saktë)!

- a) Lagja numër nëntë është pjesë e madhe e qytetit të Parisit. _____
- b) Bashkëmoshatarët dolën në skenë dhe nuk u përshëndetën. _____
- c) Arbri filloi. Ishte viti 1995 kur lashë vendlindjen time, Shkodrën. _____
- ç) Shqiptarët janë shumë të gëzuar, myslimanët vijnë të festojnë së bashku me të krishterët. _____
- d) Një djali i ri dha një mendim vërtet të mrekullueshëm. _____
- dh) As vetë nuk e dinte përse i erdhi kjo valë hidhërimi. _____

3. Përfytyroni një festë ndërkulturore në lagjen ose komunën ku banoni tash, të ndarë në grupe prej 2-3 nxënësve/eve! Mendoni për pyetjet në vijim:

- Cilat komunitete/kombësi jetojnë atje dhe do të merrnin pjesë?
- Çfarë programi do të mund të bënit?
- Çka mund të kontribuojnë grupet e veçanta?
- Çfarë do të ishte tipike për shqiptarët?
- Çka do të mund të kontribuonin vendosit/et e vendit ku jetoni?

Bëni dhe shënoni një planifikim sa më konkret!

Bisedoni për këtë me mësuesin/mësuesen!



MIQËSIA E RE



Prishtina është kryeqyteti i Kosovës. Shtrihet në luginën e dy lumenjve të vegjël (tash të mbuluar), Prishtevkë e Vellushë, në një lartësi 585 metra mbi nivelin e detit. Në lindje lartësohen kodrat e Gërmisë, ndërsa përballë hapet panorama e fushës së Rrafshit të Kosovës. Në juglindje, rreth 10 km prej Prishtinës gjenden rrënojat e qytetit të madh antik ilir, Ulpiana. Pasi u dëmtua nga një tërmet, ky qytet i lashtë u rindërtua në vitin 518 nga perandori bizantin me orgjinë ilire Justiniani II. Në vetë territorin e Prishtinës janë gjetur gjurmë të një qytetërimi mijërvjeçar. Sot është qyteti më i madh i Kosovës dhe ka rreth 400 mijë banorë.

Disa nxënës nga Kosova, dy prej të cilëve nga Prishtina, kanë ftuar një grup shokësh dhe shoqesh nga Zvicra për t'i kaluar pushimet e verës tek ata. Nxënësit e të dy vendeve janë vendosur në pushimoren e Gërmisë. Ata së bashku luajnë, lahen në pishinë, shëtisin në pyllin plot me drunj të gjelbëruar. Dje vizituan Ulpianën. Çfarë mrekullie! Klodi bëri shumë fotografi. Sara bleu disa kartolina që t'i ketë si kujtim. Linda do të shkruajë në ditar përshtypjet e saj nga Prishtina. Miri pikturoi një pamje vere. Fabiani u shkroi prindërve të tij. “Ja tek jam më në fund me pushime në Kosovë. Kam bërë shumë gjëra dhe kam takuar plot njerëz. Kam blerë plotë dhurata.”

Pushimet arritën në fundin e tyre. Ata kënduan këngën “Lamtumirë”.

Pushimi iku shpejt
Të gjithë së toku qemë të lumtur!
Erdhi çasti i lamtumirës.
Nuk dëshironim asgjë më shumë.
Miq të dashur, ne duhet të ndahemi.
Miq të dashur, ne duhet të ndahemi.
Lamtumirë!
Kënga jonë jehonte deri vonë.
Mirupafshim, përsëri!
Pas pushimeve, kur Klodi u kthye në Zvicër, i shkroi një e-mail mikes së re Kaltrinës, nxënëse e klasës së 7-të pranë shkollës “Elena Gjika” të Prishtinës.

Bern, më 15 korrik

E dashur Kaltrinë,

Kur po të shkruaj, po të kujtoj me mall. Si je? Ç'bën? Unë bëra një udhëtim të mirë. Këtu në Zvicër bie shi. Jam pak e mërzitur, se pushimet e bukura kaluan aq shpejt. Asnjëherë nuk do ta harroj vendin tënd, Kosovën e bukur.

Të përqafon mikja jote,

Klodi

Prishtinë, më 16 korrik

Falënderim

E dashur Klodi,

Të falënderoj për atë që më shkruan. Për mua është kënaqësi e veçantë që jam njohur me ty. Gëzohem që keni kaluar mirë rrugës. Përshëndete nënën tënde nga unë. Ju përqafoj me mall!

Mikja jote,

Kaltrina

1. Përgjigju pyetjeve!

- a) Pse qyteti Ulpiana u ndërtua nga perandori romak Justiniani II?
- b) Në cilin shekull Perandoria Romake filloi shtrirjen mbi disa qendra të Ilirisë?
- c) Perandor i kujt ishte Justiniani II?


2. Mësojmë!

Iliria (një pjesë e saj), që në shek. I-rë para erës sonë u gjend nën sundimin e Perandorisë Romake (atëherë shteti më i fuqishëm i kohës) dhe kjo ndikoi shumë nga pikëpamja politike dhe kulturore në historinë e popullit tonë. Një pjesë e Ilirisë ra nën sundimin bizantin, pas ndarjes në dy pjesë të Perandorisë Romake.

3. Lidhini me një shigjetë fjalitë sipas kuptimit!

1. Vendku banuan ilirët e Perandorisë Romake
2. Iliria ra nën sundimin e quhej Iliria.

3. Justiniani perandor romak. i Kosovës.
4. Në lindje lartësohen. me origjinë ilire.
5. Nxënësit e dy vendeve janë vendosur shoqes së re.
6. Nxënësit kënduan. këngën “Lamtumirë”
7. Prishteva dhe Vellusha lumenj të mbulua.
8. Prishtina është kryeqyteti kodrat e Gërmisë.
9. Obiliqi është i pasur. me thëngjill.
10. Klodi nga Zvicra u miqësua. me Kaltérinën nga Kosova.
11. Klodit i shkroi një e-mail. në pushimoren e Gërmisë.
-
- 4. A ke krijuar edhe ti miqësi të reja (ose ke ripërtrirë miqësi të vjetra) në Atdhe?**
Shkruaj për këtë në fletoren tënde dhe lexoje pastaj para klasës!
-
- 5. Kërkoni në grupe të vogla në internet çka mund të gjeni për Prishtinën e vjetër dhe të sotmen! Bëni një pllakat dhe ua tregoni bashkënxënësve/eve!**




NË FESTIVAL

E shtunë, më 14 tetor

Sot është ditë e veçantë, sepse ka filluar pushimi vjeshtor.

Besa dhe Klea kanë përgatitur valixhet e udhëtimit. Ato së bashku me miqtë e tjerë do të marrin pjesë në Festivalin Ndërkombëtar të Këngës në Athinë. Ato nisen nga Berlini. Me vete morën kitarat dhe ëndërrojnë se do të hyjnë në listën e këngës fituese. Dolën nga shtëpia në orën 07, 00 të mëngjesit. Shkuan drejt për Zvicër. Pastaj kaluan nga Berni, ku takuan mikun e tyre zviceran, Johanin. Besa dhe Klea në kolegj, përveç gjermanishtes, kishin mësuar edhe anglisht dhe frëngjisht. Por ato nuk dinin as italisht, as greqisht. Në orën 18, 00 arritën në Romë. Por këtu filluan problemet. Duhej të flisnin italisht. Johani kishte harruar adresën e miqve italianë. Pas pak pyetën Pablon, një shok që njihte Lukun. Fatbardhësisht, në orën 10, 00 të mbrëmjes, Luku dhe Renata i priten miqtë e tyre në shtëpi.



Më 15 tetor, të gjithë së bashku, hynë në kufirin e Greqisë. Por Besa harroi pasaportën në anije dhe nuk dinte ta kërkonte greqisht, kurse polici nuk dinte gjermanisht. Çka do të bënte? Klea filloi t’ia shpjegojë anglisht. Polici dëgjonte me vëmendje, por nuk e kuptonte. U afrua Luku dhe ia shpjegoi italisht. Ai tha duke qeshur: ”Ashtu! Në anjen “Liburna”zonjusha ka harruar pasaportën dhe në Greqi nuk mund të hyjë pa të. Pritni pak, të pyes se kur kthehet anija përsëri? Alo! . . . po, në orën 18 e 30 min. . . . Faleminderit! Dëgjoni! Duhet të pritni një orë për ta marr pasaportën”. Besa u gëzua shumë kur e mori pasaportën. Më në fund arritin në Athinë. Johani, që kishte mësuar greqisht, pyeti se ku gjendej ndërtesa ku do të bëhej Festivali Ndërkombëtar i Këngës. Përgjigjen nuk e kuptoi qartë. Për fat, Besa e kishte një kushëri që jetonte në Athinë dhe i kërkoi ndihmë. Të rinjtë ishin të lodhur, por të kënaqur. Kudo dëgjohej jehona e këngës anglisht, gjermanisht shqip, italisht, danisht, suedisht, greqisht, frëngjisht. Besa nxori dorëshkrimin e këngës dhe lexoi hyrjen:

**Zgjatni duart, vini gurë!
Të ndërtojmë mbi lumë urë!
Të kalojnë ata që duan,
Të shuajnë dhimbjet që s’thuhen.**

Pasi panë festivalin, të rinjtë u përshëndetën me njëri-tjetrin, u përqafuan dhe u puthën me miq të rinj.

1. Lexoni pyetjet dhe përgjigjuni!

- Ku jetonin Besa dhe Klea? _____
- Pse shkuan në Athinë? _____
- Me çka udhëtuan ato? _____
- Si quhen miqtë e Besës dhe Kleas? _____
- Cilat gjuhë dinin ato ? _____
- Cilat probleme u lindën atyre? _____

2. Dëgjoni dhe bëni shënjën [X] përpara fjalisë së saktë!

- Besa dhe Klea shkuan në Athinë, ku bëhet Festivali Ndërkombëtar i Këngës.
- Besa dhe Klea u nisën nga Vjena.
- Rrugën deri në Zvicër e bënë autostop.
- Më 15 tetor Besa me shokë dhe shoqe hynë në kufirin e Greqisë.
- Polici dëgjoi me vëmendje dhe kuptonte anglisht.

- _____ dh) Në orën 18, 00 kanë arritur në Romë.
- _____ e) Kudo dëgjohej jehona e këngëve anglisht, shqip, gjermanisht, frëngjisht, italisht.
- _____ f) Besa nxori dorëshkrimin e këngës dhe filloi ta lexonte:
- _____ g) Pasi panë festivalin, të rinjtë u puthën, u përqafuan dhe u ndanë me miqtë e rinj grekë.

3. Plotësoni tekstin me fjalë të munguara, mësone përmendsh dhe bisedoni lidhur me të!

- Zgjatni _____ vini gurë.
- Të ndërtojmë mbi lumë _____
- Të _____ ata që duan.
- Që të shuajnë _____ që s'thuhen.

4. Cilën këngë do të këngonit ju në një festival të tillë? Nëse jeni guximtarë, sajoni vetë një tekst të përshtatshëm pér një rast të tillë!

Dëgjoni këtë këngë të bukur shqipe pér dashurinë që lind në bankat shkollore.
Mësoni ta këndoni! <http://www.youtube.com/watch?v=Tauq66K9Po&feature=related>

BIE SHI

Metorologu sjell lajmet më të fundit mbi parashikimin e kohës. Buletini meteorologjik parashikon:

Kohë me diell. Moti është i mirë. Dielli djeg. Është vapë.



Koha është e ndryshueshme, me shi dhe diell.

Në qill duken retë.




Koha është e vranët. Bie shi. Është shtrëngatë.

Shi me breshër. Rrufeja vret.



Bie borë. Fryn erë e vrullshme, tufani.




• Vapë

• Nxehtë

• Ngrohtë

• Freskët

• Acar



- Babai: Anila, ku po shkon?
- Anila: Po dal pak, babi. Po shkoj te Toni.
- Anila: Auu. . . çfarë shiu!
- Nëna: Merre çadrën! Bie shi.
- Babai: Shpejt do të ndalet, ky është vetëm një shi vere.
- Anila: Mami, ku është çadra ime?
- Nëna: Është aty në orman, në paradhomë
- Anila: Jo, nuk është këtu. Nuk e gjej dot.
- Nëna: Shiko mirë. Ajo duhet të jetë aty. Ja, çka është kjo?
- Anila: Jo, kjo nuk është çadra ime, por është çadra e Gentit.
- Nëna: Atëherë, shiko në dollap ndoshta është atje.
- Anila: Jo, kërkova çdo skutë nuk e gjej. Ku mund të jetë ?
- Nëna: Oh, bija ime. Ti shpesh nuk di ku i lë gjërat e tua?
- Anila: Nënë, a mund ta marrë çadrën tënde?
- Nëna: Sigurisht që mundesh. Merre!
- Anila: Faleminderit, nënë.



Ishte mesditë. Anila rrinte ulur dhe po dëgjonte me vëmendje emisionin televiziv. Në mëngjesin e sotëm, erërat e forta dhe shirat e rrëmbyeshëm të uraganit “Irene” goditen Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në Nju-Jork ka përmbytje, ndërprerje të energjisë elektrike nga një stuhi “tejet e rrezikshme.” Kryetari i bashkisë urdhëroi largimin e banorëve. Ai u tha: Moti është i keq. Ka nisur të bjerë shi. Ky është vetëm fillimi. Mos prisni! Mos u vononi! Ju thoni se janë vetëm disa pika, por kjo do të jetë një stuhi serioze që kërcënlon jetën e njerëzve këtu”. Rreth 370. 000 banorë kanë lënë shtëpitë e tyre. Është mbyllur gjithë sistemi i transportit publik, i metrove, autobusëve dhe tre aeroportet më të mëdha. Për tri ditë stuhia e uraganit ishte e frikshme, duke lënë 15 njerëz të vdekur, shkatrime, përmbytje, uji ka mbuluar rrugët. Pemët janë shkulur. Fuqia e erërave ishte deri në 150 km në orë.

Detyra

1. Sajoni në grupe prej dy vetash një dialog për motin, siç e bëjnë dy persona që takohen në rrugë. Mund të fusni edhe elemente humoristike. Luajeni dialogun si skenë para klasës!

2. Përshkruajini në një letër përjetimet tuaja më të tmerrshme në një mot të keq (secili/a në një letër të veçantë)! (Nëse doni, mund të sajoni edhe një aventurë të tmerrshme!)

Shkruani në mënyrë sa më tërheqëse për lexuesit/et!

Bëni edhe një vizatim për këtë aventurë! Krijoni një letër A3 me tekst dhe vizatim.

Bëni një lexim dhe një eksposítë në klasë me tekstet dhe me vizatimet tuaja!

3. Plotësoni fjalitë me fjalë të figurave të dhëna!



1. Në dimër _____ ka mbuluar malet.

2. Është _____ kam nevojë për ujë

3. Ka aq shumë _____ sa që nuk shoh as dy metra.

4. _____ i motit ka paralajmëruar shi pas dite.

5. Kam frikë nga _____ sidomos nga _____

6. Sot koha është e mirë, por rreth diellit duken _____.

7. Flamuri valëvitet prej _____

8. Kur bie _____, mos e harro çadrën.

9. Eja shiko diellin kur _____

10. Pas shiut në qiell duket _____.

4. Shikoni me vëmendje lajmet meteorologjike (për motin)

në televizionin shqiptar (TVSh; RTK ose çka ju pëlqen) dhe

në televizionin e vendit ku jetoni dhe merrni shënime për pyetjet vijuese gjatë shikimit:

a) Përshkruani sa më saktë si jepen lajmet meteorologjike në secilën prej dy stacioneve (si është skenari, mjedisi, sipas cilit rend jepen lajmet meteorolgjike etj.)!

b) Çka janë të mirat dhe jo aq të mirat e secilit kanal televiziv; çka ju ka pëlqyer (në kuptimin informativ) më shumë në këtë apo atë kanal?

c) Shkruani një letër me popozime për përmirësime të mundshme njërit prej dy kanaleve!

5. Përktheni fjalët vijuese në gjuhën e vendit ku jetoni! dielli, ylli, qielli, stuhia, akulli, bubullima, vetëtima, hëna, tërmeti, përmbytja, uragani.

6. Ja dhe një këngë e bukur *Djaloshi dhe shiu*, kënduar nga e madhja Vaçe Zela.

<http://www.youtube.com/watch?v=KqtkhNT8SQU&feature=related>

Djaloshi dhe shiu

Presto

15

22

29

Ja shi-u pik pik pik pik bjennë rug' tro-ket ai pa pu-shum e o-ra

tik tak tik tak shkone dja-li pret me pa du-rim o ze-mra tak tak tak tak

pse tash-ti me rrah me kaqx - tim men-don-dja-lo-shi që po pret në

shi me an-dje dhe gë-zim ja shi-u zim bin-te shi por ai se vin-te

re as-pak pér çu-di as um-bre-llën nuk e kish-te hap tuj men-du

se si erdh a - jo me - zi një dit stu - den - tesh e bu - kur pér prak - tik'

NË RESTORANT


Është e mëkurë, koha e drekës. Arta, Doku, Bujari dhe Nolani dëshirojnë të hanë e të pinë së bashku në restorantin e shkollës që është hapur para disa ditësh. Ai u ofron ushqim të larmishëm çdo ditë më shumë se 300 fëmijëve.




Doku



Arta



Bujari



Nolani

Çfarë mund të gjeni në tavolinën tuaj?

Meny

Hamburger.....	2,00 €
Lëng pemësh.....	0,80 €
Sanduiç.....	2,10 €
Limonadë.....	0,80 €
Omëletë.....	2,50 €
Koka-kolë.....	0,90 €
Sallatë.....	1,20 €
Qumësh.....	0,80 €
Mish pule.....	3,20 €
Ujë.....	0,70 €
Patate të fërguara.....	2,30 €
Çaj.....	0,70 €
Akullore.....	1,00 €
Kafe.....	0,85 €
Pastë me shkumë.....	0,30 €
Ujë me gaz.....	0,80 €
Ëmbëlsirë.....	1,00 €



Arta: Nuk paska shumë njerëz, por qenka lokal i mirë.

Bujari: Ku ju pëlqen të ulemi, jashtë apo brenda?

Doku: Më mirë këtu jashtë. Në verandë paska hije dhe ajri është më i pastër.

Nolan: Edhe mua më pëlqen këtu.

Bujari: Kamerier, a mund të porosis? Çfarë gjellësh gatuani këtu?

Nolani: Po çmimet si janë ?
Kamerieri: Urdhëroni, çfarë dëshironi? Urdhëroni menynë.
Doku: Sa për fillim, do të doja një sallatë me tranguj.
Më pastaj më sillni një omletë me vezë.
Kamerieri: Po për të pirë çfarë dëshironi? Kemi lëng dredhëze, boronice...
Doku: Një limonadë, ju lutem!
Nolani: Mua më sill një hamburger dhe një koka-kolë të madhe me akull.
Arta: Unë dua një pjesë mish pule me patate të fërguara, ju lutem pak kripë, piper dhe një çaj.
Bujari: Unë dëshiroj një sanduiç dhe një ujë me gaz, ju lutem.
Kamerieri: Po, si urdhëroni.
Arta: Patatet janë të ftohta. Unë kam porositur të ngrohta e ju më sillni
Kamerieri: E ktheni këtë, ju lutem. Dëshironi diç tjetër ?
Doku: Po nga një akullore e doni?
Arta: Më mirë është të marrim vetëm pemë, sepse është pranvera dhe kemi nevojë për vitamina.
Nolani: Ky kamerier qenka shumë i sjellshëm. Po shërben shkëlqyeshëm.
Bujari: A keni pemë për të gjithë? Na sillni gjithashtu llogarinë, ju lutem, që të paguajmë.

Kamerieri: Posi, kemi. Mund t'i lini t'i paguajnë prindërit?

- 1. Lexojeni tekstin. Shtrojini njëri-tjetrit pyetje për tekstin siç i shihni më poshtë:**
- Çka hëngër Doku?
 - Çka piu Bujari?
 - Çka porositi Arta?
 - Çka i pëlqeu Nolanit të hante e të pinte?

- 2. Cili është restoranti yt i preferuar? Pse? Çka të pëlqen atje më së shumti?**



3. Çka dini për restorantet në vendin ku jetoni në krahasim me ato në trojet shqiptare (lidhur me ambientin, gjellërat, çmimet, cilësinë etj.) ?

Përshkruani në një fletë të veçantë përvojat tuaja dhe bëni një krahasim (mund ta bëni edhe në formën e një tabele)!

4. Sikur të hapje një restorant, si do të quhej ai, ku do të gjendej, si do ta mobiloje, çka do të kishte në meny? Bëj një pllakat reklame për restorantin tënd duke e përshkruan në mënyrë sa më térheqëse!

5. Shumë shqiptarë punojnë nëpër restorante ose hotele.


Çka di ti për profesionet që lidhen me restorantet dhe hotelet edhe për njerëzit që punojnë atje?

Bëje një listë, shkruaj çka di ti, cilat të duken të mirat e të këqijat e atyre profesioneve.



ÇKA KA VESHUR AI / AJO?

Njerëzit zakonisht mbajnë veshje që u përshtaten punëve që bëjnë ose mënyrës së jetesës. Rrobat janë nga pambuku, stof leshi, mëndafshi e të tjera. Me ngjyra dhe motive të ndryshme!



e bardhë e zezë, e kaltër, hiri, e kuqe, portokalli, e verdhë, jeshile, gjelbër, gështenjë, kaltër, vjollce, drap, trëndafili;

stof me pika, me vija, me katrörë, kadife, fije leshi, fije pambuku

Tina hyn në butikun e modës:

- Do të blija një fustan nga pambuku, - tha ajo. Dëshiroj ta shoh ketë!

Shitësja: - Çfarë numri keni? Çfarë ngjyre doni?

Tina: - Mbaj numër 38. Mundësish, të kaltër.

Shitësja: - Çka mendoni për këtë? Provojeni, ashtu. . . Ju jeni veshur bukur, ju rri shumë mirë. Fustani i kaltër dhe manteli mavi, ju kanë hije!

Petriti vesh rroba që tregojnë autoritetin dhe postin e tij. Ka veshur kostum jeshil, këmishë të bardhë, kravatë me vija të kuqe dhe zeza, sipër një mantel drap, ka mbathur këpucë ngjyrë gështenje.

Valit i pëlqejnë rrobat sportive, që janë të lehta dhe të thjeshta. Ai ka veshur pantallona xhins të kaltër, bluzë të gjelbër, sipër ka xhemper portokalli dhe ka mbathur atlete të kuqe.

Vlorës i pëlqen të vishet me rroba që tërheqin vëmendjen dhe e bëjnë të bjerë në sy. Ajo ka veshur bluzë të shkurtër të kuqe me vija të zeza dhe me pantallona dhe xhup të kaltër dhe çizmeve të zeza.

Genti ka pantallona të rehatshëm prej kadifeje ngjyrë gështenje, rrip të kuq, bluzë të bardhë e sipër ka setër të gjelbër dhe këpucë me qafë.

Ejona vishet sipas mënyrës klasike. Sot ajo ka veshur fund të ngushtë të shkurtër të zi, xhaketë të verdhë dhe këpuca të zeza të rrafshëta.

1. Përshkruaje stilin tënd si vishesh zakonisht apo çfarë rrobash të pëlqejnë!

2. Shumë të rinj çmenden pas rrobave ose këpucëve të markave të njohura.

Si silleni ju në këtë pikëpamje; çfarë rëndësie kanë rrobat a këpucët me marka për ju? Diskutojeni në grupe këtë çështje dhe krahasoni mendimet tuaja.

3. Sikur të kishe në dispozicion 500 Euro për rroba dhe këpucë, çka do të blyje?

Krijon një vizatim me ato rroba dhe me llogarinë e çmimeve!


4. Ta ushtrojmë fjalorin tonë! Merr një fletë, shkruaj emrin e secilës veshje sipas fotografisë (prej A deri X) në gjuhën shqipe si dhe në gjuhën e vendit ku jeton! (Nëse mundesh, bëje edhe në anglisht ose në një gjuhë tjeter që e zotëron!)



A



B



C



D



E



F



G



H



I



J



K



L



M



N



O



P



Q



R



S



T



U



V



W



X

PËRSHTYPJE NGA SHËTITJA



Tina tregon

Pranverë. Ishte e diel. Jashtë dielli shkëlqente në qiellin e ndritur e të kaltër. Të gjithë së bashku u mblodhën në oborrin e shkollës dhe prisnim të niseshim për në shëtitje. Do të shkonim në pyllin me pisha që ndodhej jo shumë larg. Shumica ishin veshur me xhinse dhe atlete. Unë kisha veshur pantallona të shkurtër, një bluzë të hollë dhe një palë atlete. Isha shumë e gjëzuar. Me vete kishim marrë edhe ushqime, po edhe gjëra të tjera për të luajtur e për t'u argëtuar. Kur u nisëm, ishte ora shtatë e mëngjesit. Nuk kishim ecur më shumë se gjysmë ore dhe para nesh filloj të shfaqej një pamje e këndshme. Një lëndinë midis shkurreve, por ne vendosem të shkonim më tutje. Te një shpat i vogël u ngjitëm me lehtësi. U vendosëm diku aty pranë shkëmbinjve dhe grupë-grupe pranë njëri-tjetrit filluam të përgatitnim vendin. U rregulluam shpejt dhe secili sipas shijes filluam dikush të luante me top, dikush të vravonte te burimi. Të tjerët u mblodhën te trupi i një peme dhe, si pa pritur, zëri i një kitare filloj të përzihet me thirrjet e vajzave e të djemve që luanin të gjëzuar.



Unë kisha zënë një qoshe aty pranë pemës dhe, e gjëzuar, dëgjoja zërat e shokëve që këndonin dhe i binin kitarës. Ashtu, me këngë dhe lojëra, kaloi ajo ditë që nuk do ta harroj kurrë.

U kthyem vonë. Ishim, sigurisht, pak të lodhur, po shumë të kënaqur, se kishim kaluar një ditë të bukur.

Genti tregon



Një ditë shkuam në pyll. U nisem nga shkolla dhe mbërritëm atje pas një ore e gjysmë. Luajtëm dhe kënduam deri vonë. Me vete kishim marrë ushqime. U kthyem vonë dhe ishim pak të lodhur. Atje hëngrëm të gjithë së bashku nën hijen e pemëve.

Dëgjoni dhe mësoni ta këndoni këtë këngë të bukur shqipe “Bylbyli në pranverë”, kënduar nga Frederik Ndoci! http://www.youtube.com/watch?v=8dZ_ERQ88Nc&feature=related

1. Përgjigjuni pyetjeve!

- a) Lexoni dy tekstet e mësipërme. Çka ju bie në sy, çka ju bën përshtypje?
- b) Si janë përshkrimet në të dy tekstet?
- c) A janë përshkruar ngjarjet sipas radhës?
- ç) Çfarë ndryshimesh vini re nga njëri tekst në tjetrin?



2. Mësojmë

- Kur doni të tregoni përshtypjet tuaja nga një shëtitje, duhet të bëni një paraqitje të plotë e të saktë të asaj që keni përjetuar.
- Përjetimet tuaja duhet t'i paraqitni sipas radhës dhe në veten e parë.
- Paraqitja e tregimit ka tri pjesë themelore: hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen.
- Në hyrje jepen vendi, koha dhe personat pjesëmarrës. Hyrja u përgjigjet pyetjeve: ku, kur, kush. . . .

3. Përshkruani një ngjarje ngajeta juaj duke ju përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:

- Për cilën ngjarje do të tregoni diçka (hyrja)?
- Ku dhe kur ishit? Kishte të tjerë veç jush?
- Si u zhvilluan ngjarjet ?
- A patët probleme?
- Si i zgjidhët ato?
- Shkruani edhe 2 - 3 fjali si mbyllje të hartimit.

4. Shkruani përshtypjet ose përjetimet tuaja nga një piknik, për një ndeshje futbolli ose për një film që keni parë! Ndërtojeni tekstin sipas pikave të mësipërme! Nëse s'keni mjaft vend këtu, merrni një fletë të veçantë!

MJEDISI NA TAKON TË GJITHËVE

Shikojini fotografitë dhe bisedoni në grupe rreth mjedisit të secilës!

Shkruaj legjendën përkatëse nën fotografi! **liqen bjeshke – bregdet – lagje qyteze – pamje nga një qytet i madh – fshat – fushëlartë.**



1. _____

2. _____

3. _____



4. _____

5. _____

6. _____

Mjedisi u përket të gjitha gjallesave ku ato janë krijuar, janë zhvilluar dhe vazhdojnë të jetojnë e të zhvillohen në vazhdimësi. Mjedisi është vetë natyra ku janë prezent faktorët e jetës: uji, ajri, dielli, dheu, organizmat e gjallë. Në organizma bën pjesë edhe njeriu si faktor me ndikim të madh në natyrë. Njeriu, me veglat e tij të punës, ka bërë që shumë gjëra të ndryshojnë në mjedisin jetësor. Disa nga ndikimet e tij janë negative. Ato kanë shkaktuar vdekjen e shumë organizmave shtazorë e bimorë, në shumë raste zhdukjen e llojit të caktuar. Nga këto veprime negative janë në zhdukje me mijëra lloje gjallesash. Kjo ka ndikim shumë negativ në natyrë dhe për vet vet njeriu si pjesë e saj.

Ndezjet e plehrave pa kontroll, tymtarët e fabrikave, hedhurinat radioaktive në dhe, ajër e ujë janë veprimet më negative në natyrë nga njeriu. Këto duhet ndaluar para se të shkatërrohen mjedisi jetësor e bashkë me të edhe vetë njeriu.

Përgjigjju pyetjeve!

1. Si duket mjedisi në shkollën tënde, i pastër apo i ndotur? Pse?

2. Si duket shtëpia juaj, e ndotur apo e pastër dhe kush e pastron atë rregullisht?

3. Cilat lloje të shtazëve janë të rrezikuara në rrëthim tënd?


4. Çka është ndërmarrë që të mbrohen shtazët në rrezik?

5. Shkruaj emrat e parqeve kombëtare në vendin ku jeton!

6. Cili nga parqet kombëtare të pëlqen? Cilat bimë e shtazë i njeh ti dhe cilat jetojnë aty?

**Kërko në internet parqet kombëtare në trevat shqiptare dhe në vendin ku jeton!
Shkruaj emrat e tyre!**

KUJDESI NDAJ SHËNDETIT



Çka kuptojmë me shëndet?

Shëndeti është gjendje e mirë e organizmit. Të jesh aktiv në jetën e përditshme, të ndihesh mirë fizikisht dhe shpirtërisht. Secili njeri i ka kërkesat e tij dhe obligimet ndaj detyrave të përditshme.

Populli thotë: Mendja e shëndoshë në trup të shëndoshë”?

Kjo është e thjeshtë. Kujtoje veten se si mund të mësosh një ditë kur je i sëmurë apo i ftetur nga akullorja e ngrirë.

Si ta ruajmë shëndetin?

Shëndeti ruhet:

- përmes ushqimit të duhur e vitaminoz,
- veshmbathjes dhe
- aktiviteteve sportive.

Ushqimi i rregullt dhe i gjithanshëm është kusht i organizmit të shëndoshë. Ngrënia me rregull e shujtave ushqimore (mëngjesit, drekës dhe darkës) ka rëndësi për ruajtjen e shëndetit.

Po pijet? Cilat preferohen?

Uji dhe vetëm uji i pastër. Jo lëngje, jo ujë të gazuar, jo: fanta, koka-kola, sprajt etj. Jo pije energetike. Lëngjet e pemëve nuk preferohen gjithmonë. Vetëm pasi të pimë ujë disa herë mund të pimë edhe lëngje pemësh. Pse? Ngase, ato kanë edhe materie konservuese jo të dobishme për organizmin.

Çka kuptojmë me ushqim vitaminoz?



Ushqimi vitaminoz është ushqim i gjithanshëm me perime, pemë, drithëra dhe ushqime me origjinë shtazore: qumështi, mishi e vezët. Disa prodhime ushqimore nga shtazët kanë shumë energji, andaj duhet ngrënë me masën e caktuar. Ato mund të shkaktojnë mbipeshë trupore e cila e dëmton organizmin. Në radhë të parë dhjami e dëmton punën e zemrës.

Si ndikon sporti?

Ndikimi i sportit është shumë pozitiv. Që nga fëmijëria, marrja me sport e forcon organizmin. Të gjitha sportet e ndihmojnë rritjen e zhvillimin e të riut. Sporti ndikon mirë në të gjitha moshat e jetës.

Çka e dëmton shëndetin?

Shumëçka e dëmton shëndetin. Bie fjala, papastërtia e organizimit krijon kushte për prani të viruseve e të baktereve si sulumesit aktivë të shëndetit. Fjala popullore „Pastërtia është gjysma e shëndetit” është domethënëse. Që të jemi të pastër duhet mbajtur mirë higjenën personale, në radhë të parë t'i mbajmë të pastra duart, gojën dhe hundën. Nga andej do hyjnë në organizmin tonë mikroorganizma të dëmshëm.

Po duhani, alkooli, droga si ndikojnë?

Këto janë armiqtë më të rrezikshëm të organizmit tonë, veçantë një organizmi të ri i cili është në zhvillim.

1. Shëno veprimet pozitive me + kurse negativet me – në fjalitë e mëposhtme!

Merr ushqimin me rregull.		
Nuk ha pemë e perime, ha shumë ëmbëlsira.		
Pi qumësht dhe ha pemë e perime.		
Ha bukë e prodhime drithi në masën e duhur.		
Asnjëherë nuk bën aktivitete sportive.		
Merret me not dhe me sporte të tjera rregullisht.		
Asnjëherë nuk ka përdorur substanca helmuese si duhani etj.		
Gjithmonë i lanë duart, dhëmbët, hundën.		
Nuk i intereson higjiena personale, nuk i lan as dhëmbët rregullisht.		
Shoqërohet me njerëz të dyshimtë që sillen rrugëve.		

2. Diskutojini çështjet vijuese! Përgjigjuni pyetjeve!

- a) Si veproni për ta ruajtur shëndetin tuaj?

- b) Cilat ushqime i hani me shumë? A do të ishte mirë po të ndryshonit diçka?

- c) Me cilat sporte merreni? Çka ushtroni me ato sporte?

- ç) Pse thuhet: "Pastërtia është gjysma e shëndetit"?

SPORTI, KALITJA DHE SHOQËRIA

Këto janë tri simbolet e olimpiadës: rrathët pesëngjyrësh, flamuri olimpik dhe flaka olimpike.

Diskutoni në grup lidhur me këto simbole. Çfarë rëndësie ka sporti për ju? Shkruaj emrin përkatës nën këto figura!



Mësuesja e filloj orën: Të gjithë ju keni njohuri rreth sportit dhe luani lojëra të ndryshme. Arenat sportive, sallat, fushat, poligonet, ringjet, vendskijimet, pishinat janë pikëtakimi më i mirë i të gjithëve. Bota e sportit është e gjerë dhe u përket të gjithëve, pa marr parasysh përkatësinë etnike, fetare, moshore, gjinore. Njerëzit janë vërtet shumëngjyrëshi më tërheqës në arenat sportive.

Besarta: Këtë muaj ishin lojërat olimpike, sa do doja të ishin prapë?

Mësuesja: Ato zhvillohen në çdo katër vjet. Në gjithë botën me kënaqësi shikohen lojërat olimpike. Këtë javë do të punojmë në projektin me këtë temë. Secili do të ketë detyrat e tij. Ferdinandi do t'i punojë pesë rrathët me ngjyra të ndryshme. Mos harroni, çdo olimpiadë i ka tri simbole: rrathët, flamurin dhe flakën olimpike.

Albani: Mësuese pse janë pesë rrathë, çka paraqesin ata?

Mësuesja: Rrathët shumëngjyrësh simbolizojnë pesë kontinentet. Lidhja e pa ndarë e tyre shpreh lidhjen e të gjithë neve në klasën tonë. Bango nga Amerika; Takeshi nga Azia; Denigo nga Afrika, Borigo nga Australia dhe Hansi nga Evropa, do të ngjyrosin rrathët në kartonin ku do të varën të gjitha materialet e të gjitha grupeve të punës.

Lindita: Sa zgjat projekti, zonja mësuese?

Mësuesja: Klasa e jonë do të shndërrohet në një atelie olimpiade. Ju do të punoni sipas programit. Kemi krijuar ambient pune, gjithkah ngjyra, gazeta, fletë, fotografji, libra nga lëmi i sportit. Të gjithë së bashku do të shkruani pllakatin: Sporti i miqëson njerëzit pa dallim ngjyre, gjinie, religjioni e moshe. Sporti e kalit trupin dhe shpirtin.

Sportistët janë humanistë.

Ardita dhe Liridoni të shkruajnë historinë e olimpiadës dimërore, Vjollca dhe Dreni të shkruajnë historinë e olimpiadës verore.

Sportistët krijojnë kudo shoqëri me njerëz të kombeve dhe të kontinenteve të ndryshme. Gjithkund kultivohet respekt, dashuri e miqësi. Edhe nxënësit e klasës sonë apo të një klubit sportiv.

Detyra

1. Cilat lojëra i organizoni në shkollën, lagjen apo në komunën tuaj?

2. Çka di për olimpiadat? Prej kur organizohen, sa shpesh etj. ? Shiko edhe në internet!

3. Cila nga olimpiadat dhe cili sport olimpik të pëlqen sidomos?

4. Rretho, cilat sporte të pëlqejnë më shumë! Mund ta plotësosh edhe listën

tenisi, pingpongu, noti, vrapimi, ecja, çiklizmi, motoçiklizmi, automobilizmi, shëtitjet malore, kalërimi, boksi, xhudoja, mundja, futbolli, basketbolli, hendbolli, volejbolli, bilardoja, dominoja e tjera.



5. Sajoni një program për një ditë sportive në shkollën tuaj! Krijoni një pllakat për ta promovuar këtë program. Bisedoni me mësuesin/en për mundësinë e sendërtimit!

SI UDHËTUAN PERIMET


Në botën e shkëmbimit të perimeve



Dihet se perimet janë shumë të domosdoshme për rritje e zhvillim normal të njeriut. Dikur njerëzit dinin pak për to dhe i merrnin thjesht ato që i gjenin në natyrë. Shumica nuk rritheshin në Evropë. Me shtimin e njohurive, njeriu mësoi më shumë dhe filloj t'i kultivojë ato në kopshtin e tij. Zhvillimi i lundrimit me anije tregtare tejoqeanike mundësoi njohjen dhe bartjen e tyre. Kështu filloj pasurimi i ushqimit të njerëzimit në tërë globin. Për shembull, speci, domatja dhe patatja nuk njiheshin fare. Pas zbulimit të Amerikës, këto bimë u përhapën në Evropë dhe në tokat e kolonizuara, si në Indi, Afrikë etj. Trangulli, kungulli, shalqiri dhe pjepri u përhapën nga jugu i Himalajeve në tërë botën, kurse preshi nga vendet e mesdhetare.

Udhëtimet e gjata me anije dhe me mjete të tjera transporti i dëmtonin perimet, prandaj njerëzit filluan t'i kultivonin ato. Së pari në oborret mbretërore, kurse më vonë edhe në hapësira të tjera.

Vendet ku kultivojeshin bimët nga familja e kungullit (trangulli, kungulli dhe shalqiri)



Derisa njerëzit nuk i njihnin ato, nuk dinin as t'i kultivonin dhe t'i përdornin për ushqim. Patatja e ardhur nga Amerika Jugore gjeti një shtrirje të gjerë në Evropë. Ajo plotësoi në masë të madhe nevojën për ushqimin e popullatës krahas grurit dhe misrit. Misri erdhi në Evropë nga Amerika dhe sot zë vendin e dytë për ushqimin e njeriut dhe kafshëve pas grurit.

Ja një rrëfim se si është ndikuar për përhapjen e patates në Evropë:

Një mbret në një vend evropian, duke e parë rëndësinë ushqyese të patates dhe refuzimin e fshatarëve për ta mbjellë, pasi nuk e njihnin atë, u dha urdhër ushtarëve ta mbjellin pataten në një sipërfaqe të madhe afér rrugës dhe të vendosen roje në katër skajet e arës. Njerëzëve, duke qenë kureshtarë pse ruhet kjo bimë nga ushtria, u interesonte ta kenë gjithsesi në kopshtin e tyre. Ata shfrytëzonin rastin dhe merrnin patate kur rojet nuk ishin të vëmendshëm. Kështu për pak kohë patatja u përhap shpejt në tërë rajonin.

Amerika Jugore është vendlindja e misrit, domates, patates dhe e specit.
(Shkruaj emrat në këto fotografi!)



1. Përgjigjju pyetjeve!

a) Pse nuk dihej te ne dikur për specin, domaten e pataten?

b) Si u përhap patatja në një vend evropian?

c) Çfarë pemësh dhe perimesh të tjera të importuara njeh? Nënviso ato që i do më së shumti!

2. Diskutoni në grup për të mirat e të këqijat e importit të ushqimeve nga vendet më të largëta të botës. Shënoni rezultatet tuaja në një tabelë dhe paraqitjani klasës suaj!



3. Bëni një si fjalor të vogël sipas rendit alfabetik me emrat e pemëve dhe të perimeve! Shqip dhe në gjuhën e vendit ku jetoni.



KUJDESI NDAJ GJALLESAVE

Shikoni këto fotografi! Pasi t'i shkruani emrat e qenieve të gjalla, bisedoni rreth tyre bashkë me mësuesen!



Një fjalë e urtë qe nga koha antike thotë:

“Çdo veprim i njeriut ndaj kafshëve i kthehet vetë njeriut”



Kjo tregon se qysh herët njeriu ka menduar për sjelljet e tij në natyrë dhe ndaj gjallesave në veçanti. Njeriu i njohu dhe i zbuti së pari kafshët që i duheshin për jetë. E filloj me qenin, i cili duhej për gjueti dhe vazhdoi me kafshët dhe me bimët duke i kultivuar ato. Kjo nënkupton ruajtjen e tyre dhe përmirësimin e racave dhe të varieteteve. Në ditët tona, kur janë rritur ndikimet e njeriut në natyrë me industrializimin e hapësirave, shumë lloje gjallesash janë në rrezik të zhdukjes. Njeriu ka krijuar rezervate në formë të parqeve nacionale apo natyrore për mbrojtjen e llojeve nga zhdukja.



Bimët dhe shtazët janë gjallesa të lidhura ngushtë njëra me tjetërën. Jeta e tyre është e ndërvarur. Njeriu me prerjen e drunjve të pyllit do të zhdukë shumë lloje të kafshëve që jetojnë aty. Nga kjo ndërrojnë kushtet klimatike në rrëth, nga të cilat preket i tërë mjedisi jetësor dhe njeriu, si pjesë e tij. Zhdukja e shtazëve po ashtu ndikon në zhdukjen e bimëve. Ne duhet të mësojmë për gjallesat që t'i ndihmojmë ato.

Në rrëthin tuaj ka me siguri shoqata dhe veprimtarë që merren me ruajtjen e gjallesave. Ato organizojnë mësime shtesë për nevojën e ruajtjes së rrëthit dhe të organizmave. Projekte të shumta punohen në shkolla për nevojën e ruajtjes së gjallesave nga të gjithë, si pjesë e botës së përbashkët.

Ja çka shkruan në një pllakat: *Të veprojmë në të gjitha vendet për mbrojtën e gjallesave*. Me këtë i shërbejmë njeriut dhe gjithë mjedisit.

1. Bëni një intervistë me prindërit ose me gjyshin a gjyshen duke i pyetur se çfarë kafshësh kanë pasur dikur dhe si kujdeseshin për ato. Me një referat të shkurtër, ose me një pllakat prezantoni para klasës çka keni mësuar!

2. Përgjigjuni pyetjeve!

a) Çka di për kafshët që janë zhdukur fare? Cilat janë ato? Cilat janë arsyet e zhdukjes

së tyre?

b) Çfarë janë arsyet që gjithnjë e më shumë shtazë janë të rezikuara?

SHOQET



Mësimi i paradites në gjuhën e vendit mbaroi. Shqipja dhe Albana dolën nga klasa dhe u nisën për në shtëpi. Këtë pasdite ato duhet të shkonin edhe në mësimin e gjuhës shqipe. Meqë Albana kishte munguar dy herë radhazi në shkollën shqipe, Shqipja iu drejtua:

- A do të vish në mësimin e gjuhës shqipe, Albanë?

Albana: Jo, nuk do të vij.

Shqipja: Si the, Albanë, nuk të dëgjova mirë?!

Albana: Nuk do të vij më, të thashë, sepse më duket vetja si të isha në klasën e parë apo të dytë. Mësuesja po m'i mëson shkronjat që nga fillimi.

Shqipja: Po më befason, Albanë! Po tallesh me mua, apo e ke seriozisht?

Albana: Jo, seriozisht e kam. Tash jam në klasën e shtatë, kurse në shkollën shqipe duhet t'ia filloj nga e para.

Shqipja: Mirë, Albanë, por ti e di se ne filluam të ndjekim mësimin e gjuhës shqipe me vonesë, pra nga kjo klasë. Ti e di se gjuha shqipe ka edhe shkronjat dalluese nga gjuha e vendit ku ne mësojmë. Ato duhet të mësohen patjetër që të lexosh e shkruash pa gabime gjuhën tonë.

Albana: Po, Shqipe, por unë po turpërohem nga të tjerët kur nuk po i shkruaj fjalët pa gabime. Herën e fundit, në tabelë nuk dija ta shkruaja si duhet fjalën „shtëpi“. E di ti si e shkrova „schtepi“. U zura ngushtë dhe më nuk shkoi.

Shqipja (e befasuar): Vetëm për këtë thua?

Albana: Pastaj mësuesja na e tërheq vërejtjen që mos t'i përdorim fjalët e huaja. Në një rast thashë „Bahnhof“, kurse ajo më tha: Ne përdorim fjalët „stacioni i trenit“. Njëherë tjetër thashë „në aksham“, kurse ajo më tha se kjo është fjalë turke, kurse ne e kemi fjalën tonë „mbrëmje“. Çdo fjalë që them më duket se po gaboj. Pastaj, a të kujtohet, Shqipe, kur Flamuri i tha mësueses se babai i tij punon në „baushtell“, mësuesja i tha se në gjuhën shqipe thuhet „në ndërtimtari“. Prandaj nuk dua të shkoj më në shkollën shqipe dhe dua të jem e qetë, të mësoj në gjuhën e vendit dhe gjuha shqipe s'po më duhet.

Shqipja: Dëgjo, Albanë! Për këtë që po thua një ditë do të pendohesh e do të turpërohesh shumë. Si flet ti kështu? Gjuhën shqipe e kemi gjuhë të nënës, gjuhë të Atdheut. Prindërit tanë halli i ka sjellë këtu, ku jetojmë tash, por gjuhën e Mëmëdheut duhet ta mësojmë e të mos e harrojmë kurrë. Si do të flasësh me gjyshin, gjyshen, xhaxhallarët dhe të gjithë të afërmit e tu kur të shkosh në Atdhe? Si do të komunikosh përmes internetit me shokët e shoqet e tua në Atdhe? Si do të ndihesh në të ardhmen, kur nuk do të dish të flasësh gjuhën e nënës e do të thuash se je shqiptare?

Albana: Po, por të lutem . . .

Shqipja: Mos më ndërprit, Albanë! Ne tashmë po rritemi. Nesër do të mbarojmë shkollën profesionale, fakultetin e ndoshta edhe doktoraturën. Kosova, Shqipëria dhe trojet e tjera etnike shqiptare do të kenë nevojë për ne. Sot për sot atdhedashuria jonë më e madhe shprehet duke e mësuar shkrim-leximin në gjuhën shqipe, shenjën më identifikuese kombëtare.

Albana (e emocionuar) iu hodh në qafë Shqipes e përqafoi fort dhe i tha: - Të shkojmë, Shqipe! Të lutem, harroje çfarë të thash. Ty të kam shoqen më të mirë. Tash e pas do të vij rregullisht në shkollën shqipe. Edhe unë dua ta mësoj gjuhën time, gjuhën e nënës, gjuhën e Atdheut. Mirupafshim pasdite në mësimin e gjuhës shqipe!

Para fillimit të mësimit të gjuhës amtare, kur Shqipja arriti në oborrin e shkollës, e gjeti Albanën duke e pritur me buzën në gaz. E përqafoi edhe një herë dhe hynë së bashku në klasë.

1. Lexojeni tekstin sipas roleve!

2. Diskutoni për veprimin e Shqipes dhe të Albanës. Diskutoni frontalisht cilat janë anët pozitive të mësimit të gjuhës amtare.

3. Kush të ka bindur ta ndjekësh mësimin e gjuhës amtare? A ke pasur edhe ti ndonjë shoqe që nuk merr pjesë në mësimin e gjuhës? Shkruaj ca fjali për këto pyetje.

4. Radhitni dhe numëroni fjalitë sipas kuptimit logjik të ngjarjes. Plotëso se kush flet:

_____ : Vetëm për këtë thua?!

_____ : Nuk do të vij, sepse po më duket vetja si të isha në klasën e parë.

_____ : Jo, seriozisht e kam.

_____ : Ty të kam shoqen më të mirë.

_____ : A do të vijsh në mësimin e gjuhës shqipe ?

_____ : Pastaj mësuesja na thotë që të mos përdorim fjalët e huaja.

_____ : Po tallesh me mua, apo e ke seriozisht?

_____ : Atdhedashuria jonë shprehet duke mësuar (. . .) në gjuhën amtare.

_____ : Po, por unë po turpërohem nga të tjerët.

_____ : Dëgjo! Gjuhën shqipe e kemi gjuhë të nënës, gjuhë të Atdheut.

_____ : Ti e di se gjuha shqipe ka shkronjat dalluese.

5. Diskutoni në grupe prej 2-3 vetash për çështjen «Çka është gjuha amtare për njeriun», pastaj shkruani një ese!

EVROPA, KONTINENTI YNË I PËRBASHKËT

Evropa është njëri prej kontinenteve të rruzullit tokësor. Shtrihet prej Oqeanit Atlantik, në perëndim deri te lumi Ural, në lindje. Evropa ka një sipërfaqe prej 10,5 milion kilometra katror dhe një popullsi mbi 800 milionë banorë.

Nga vjen emri Evropë?

Në Egjipt jetonte një vajzë shumë e bukur, me emrin Evropa. Derisa po luante një ditë me shoqen e vet, atë e pa nga Mali i Olimpit Zeusi, njëri prej zotave, dhe tha: „*Kjo vajzë do të jetë gruaja ime*“. U shndërrua në mëzat, notoi deri te brigjet e detit ku po luante Evropa me shoqen e vet. Ato në fillim paksa u frikësuan dhe ngurruan t’i afroheshin. Por, meqë mëzati u tregua i qetë dhe i dashur, Evropa iu afrua, e preku dhe i hipi në shpinë. Zeusi me Evropën në shpinë hyri në ujë dhe u kthyte prapa. Evropa filloj të thërriste: „*Ndihmë!*“, por më kot. Kur Zeusi dhe Evropa arritën në ishullin Kreta të Greqisë, Zeusi iu drejtua me këto fjalë: „*Ti je shumë e bukur. A do të dëshiroje të mbetesh tek unë dhe të bëhesh gruaja ime*“ Meqë edhe Evropës i pëlqeu Zeusi, iu përgjigj: „*Po me gjithë zemër*“. Ata u martuan dhe lindën tre fëmijë. Zeusi vendosi ta quaj gjithë kontinentin me emrin EVROPA.

Sipas një gojëdhëne greke

Bashkimi Evropian (BE)

Pas luftërave të gjata në mes të popujve e shteteve të Evropës erdhi koha e pajtimit dhe bashkëpunimit në mes tyre. Më 09 maj 1950 ministri i punëve të jashtme i Francës, Robert Schuman, propozoi formimin e një komisioni të përbashkët për kontrollimin e prodhimit të thëngjillit dhe të çelikut në mes të Francës dhe të Gjermanisë. Ky propozim u pranua edhe nga Gjermania, kurse në vitin 1951 edhe nga Italia, Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu. Këto janë shtetet e para të BE-së, kurse si datë e themelimit merret 9 maji. Pastaj BE-së iu bashkuan edhe shumë shtete evropiane.

Anëtarë të BE-së mund të bëhen shtetet që i plotësojnë këto kushte: të janë ekonomikisht të zhvilluara, të kenë demokraci të zhvilluar, të sundojë në to rendi dhe ligji, të respektohen të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të pakicave kombëtare, të kenë marrëdhënie të mira me shtetet fqinje.

Shtetet e BE-së numërojnë rreth 490 milionë banorë, të cilët dallohen nga gjuha, kultura, tradita, ngjyra e fytyrës, mënyra e veshjes dhe e ushqimit etj. Këto elemente identitare, pos që i dallojnë, edhe i ofrojnë popujt e BE-së.

Në gjithë BE-në fliten 23 gjuhë zyrtare. Gjuhët më të përhapura janë: anglishtja (47%), gjermanishtja (32 %) dhe frëngjishtja (28%). Një shtet mund të ketë edhe dy e më tepër gjuhë zyrtare. BE-ja i kushton rëndësi të madhe edhe mësimit dhe ruajtjes së gjuhës amtare, si element i parë i identitetit kombëtar.

BE-ja e ka flamurin e vet me 12 yje me ngjyrë të kaltër; himnin (Simfoninë e 9-të

të Bethovenit) dhe monedhën e përbashkët (Euron €, në zbatim nga viti 2002.) Ka edhe organet e veta: Parlamentin Evropian me qendër në Strasburg, Këshillin dhe Komisionin Evropian në Bruksel, Bankën Qendrore në Frankfurt dhe Gjykatën e Lartë në Luksemburg.

Përgjigjju pyetjeve!

a) Cilat janë kontinentet e tjera të botës? _____


b) Cilat shtete ballkanike e kufizojnë atdheun tënd? _____

c) Me cilat shtete evropiane kufizohet shteti në të cilin jeton? _____

ç) Cilat janë 27 shtetet e BE-së? I shkruaj në kornizë dhe ngjyrosi me ngjyrë të kuqe në hartë.

d) Lidh me shigjetë shtetin me kryeqytetin! Shkruaj emrat e shteteve në korniza!

Shqipëria	Berna
Kosova	Brukseli
Gjermania	Parisi
Zvicra	Tirana
Belgjika	Prishtina
Franca	Berlini
Suedia	Sofja
Italia	Amsterdami
Bullgaria	Stokholmi
Holanda	Roma
Spanja	Shkupi
Greqia	Vjena
Maqedonia	Madridi
Hungaria	Lisabona
Portugalia	Oslo
Austria	Athina
Norvegjia	Budapesti



LIRIA DHE TË DREJTAT PËR TË GJITHË

Provë të mbyllësh një zog në kafaz dhe do të vëresh sa vuan ai. Vëreji lulet sa me vështirësi rriten në një dhomë pa dritë e me pak ajër. Kafshët dhe bimët kanë nevojë për ajër, dritë dhe liri, por mbi të gjitha për lirinë kanë nevojë njerëzit.

Të gjithë njerëzit, pra edhe fëmijët, e duan lirinë. Por nganjëherë të rriturit, si individë, si grup shoqëror apo edhe si një popull i tërë, mendojnë se liri do të thotë të plotësosh të gjitha dëshirat dhe liritë e veta duke kufizuar liritë e tjetrit, lirinë e një grupei apo një kombi të tërë. Por ndonjë fëmijë mendon se liri do të thotë të plotësohen tekat personale; të bësh çfarë të duash, ta kënaqësh veten duke dëmtuar të tjerët.

A është i lirë ai njeri që kufizon lirinë personale të tjetrit? A është vërtet i lirë ai njeri, pra edhe ai fëmijë, që përqesh një tjetër, që tallet me një të gjyqtë, që gjuan me gurë, që dëmton çerdhet e shpendëve? A është i lirë ai fëmijë që sillet keq, që i shqetëson gjithnjë prindërit e vet, mësuesit dhe të tjerët?

Liria vetëm për përkrahësit e pushtetit apo për anëtarët e një partie politike nuk është liri e vërtetë. Liria është liri e vërtetë atëherë kur njeriu është i lirë të mendojë ndryshe dhe t'i shprehë mendimet e veta lirshëm, që nuk janë në kundërshtim me ligjin dhe konventat ndërkombëtare.

Liria ka rregulla të cilat janë të shkruara në ligjet e një shteti dhe shoqërie, në bazë të së cilave duhet të sillemi. Këto rregulla paraqesin edhe të drejtat e njeriut, të drejtat e një grupei e deri të drejtat e një kombi të tërë.

Mirëpo të drejtat dhe liritë e njeriut, të një grupei apo edhe të një pakice kombëtare, nuk respektohen në të gjitha shtetet e botës njësoj. Në shumë shtete njerëzit nuk janë të lirë t'i shprehin mendimet e veta. Ose shumë njerëz, grupe njerëzish nuk janë të lirë të ushtrojnë besimin e tyre, sepse në atë vend dominon një besim tjetër. Në disa shtete nuk u lejohet pjesëtarëve të një nacionaliteti të tërë të shkollohen në gjuhën e vet, ose të organizohen politikisht. Madje, në disa shtete të botës, njerëzit dënohen me vdekje nëse mendojnë ndryshe nga njerëzit në pushtet. Të gjitha këto kufizime paraqesin lëndim të rëndë të të drejtave dhe të lirive të njeriut. A keni dëgjuar dhe mësuar në shkollë për të drejtat e njeriut të cilat vlejnë për të gjithë njerëzit e botës? Ato nuk janë ligje që miratohen në parlament, por rregulla të cilat i takojnë çdo njeriu të botës. Të drejtat e njeriut përfshijnë shumë aspekte të jetës së njeriut; aspektin kulturor, social, politik e religioz.

Dokumenti më i rëndësishëm që përfshin të drejtat dhe liritë e njeriut është Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, e miratuar në vitin 1948, në bazë të së cilës: „Gjithë njerëzit janë të lindur me dinjitet, liri e të drejta të njëjta.“

Ndër liritë dhe të drejtat e njeriut më të njoitura janë: barazia para ligjit, liria e të menduarit të lirë, e drejta për shkollim në gjuhën amtare, e drejta për ta ruajtur kulturën e vet, liria për të punuar, e drejta familjare, liria për t'u marrë me politikë, liria fetare etj. Edhe të drejtat e fëmijëve janë të përfshira në Konventën e Kombeve të Bashkuara, të nënshkruar me 20 nëntor 1989 nga 192 shtete të botës. Sipas kësaj konverte të gjitha shtetet obligohen që t'i respektojnë këto të drejta të paraqitura në 54 nene.

Ja disa nga të drejtat e fëmijëve: e drejta për jetë, e drejta për të qenë i barabartë, e drejta për shkollim, e drejta për të marrë pjesë në ndonjë vendim që u përket fëmijëve, e drejta për të lidhur shoqëri, e drejta për të luajtur, e drejta për t'u mbrojtur nga punët e rënda e të ndaluara për fëmijë, e drejta për një shëndet të mirë etj.



1. Punë grapi: Cilat të drejta njerëzore apo të fëmijëve i njihni?

Ndahuni në grupe të përbëra nga 3-4 nxënës/e! Diskutoni dhe shkruani në një pllakat të drejtat e njeriut që i njihni. Bazohuni në aspektin: kulturor, social, politik e religjioz. Mund të kërkonni edhe në internet.

Pastaj çdo grup zgjedh tri të drejta njerëzore më të rëndësishme. Rezultatet e punës së çdo grapi i shkruani në një pllakat më të madh ose edhe në tabelë. Diskutoni dhe identifikoni!

Cilat të drejta të njeriut ju duken më të rëndësishme?

Konstatoni dhe diskutoni dallimet në mes të grupeve lidhur me e të drejtat njerëzore!

2. Kërko të drejtat e fëmijëve në një libër ose në internet! Përgjigjju këtyre pyetjeve me shkrim!

a) Cilat të drejta të fëmijëve të duken më të rëndësishme dhe pse?

b) A ka ndonjë të drejtë e cila të mohohet ty? Pse? Çka mund të bësh?

ARSIMI PËR TË GJITHË

E drejta themelore e njeriut është të jetojë i lirë, i sigurt e me dinjitet. Njëra prej të drejtave themelore të njeriut të Deklaratës së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara e vitit 1948 është edhe edhe e drejta për arsim. Përkundër kësaj, në të gjithë botën më shumë se 72 milionë fëmijë, prej të cilëve dy të tretat (2/3) janë vajza, nuk shkojnë në shkollë.

Në bazë të një studimi të UNESCO-s, nga ky numër i madh i fëmijëve jashtë bankave shkollore, 45% janë në Afrikë, 24 % në Azinë Jugpërendimore; 13% në Azinë Lindore e Pacifik, 9 % në shtetet arabe; nga 3 % në Amerikën Latine, Amerikën Veriore, Evropën Përendimore e në Evropën Qendrore e Lindore dhe 1 % në Azinë Qendrore.

Ja disa citate të fëmijëve nga vendet e ndryshme të botës:

1. «Dy herë në ditë më duhet të shkoj te burimi, 2 km larg për të marrë ujë për familjen time. Shpeshherë më duhet edhe të pres kohë të gjatë në radhë. Për këtë arsy shpeshherë vonohem në shkollë. Më vjen vështirë që pas mësimit edhe një herë të shkoj për të marrë ujë, pasi nuk më mbetet kohë për t'i kryer edhe detyrat e shtëpisë. »

2. «Unë nuk mund të shkoj në shkollë, sepse jam e verbër dhe nuk ka mësues për mua. Do të dëshiroja shumë të shkoja në shkollë me shoqet e mia, por atje nuk ka shkronja për të verbit. Në një klasë me 60 nxënës mësuesi nuk ka mundësi të më falë përkujdesje të mjaftueshme vetëm mua. »

3. «Babai më vdiq kur unë isha 11 vjeç. Ai kishte një fermë të vogël, nga e cila fitonim pak të holla. Pas vdekjes së babait m'u desh ta lija shkollën. Më duhej të ndihmoja në shtëpi dhe të kujdesesha për vëllezërit dhe motrat e mia, në mënyrë që nëna të punonte në fushë. »

4. «Ne na duhen para për uniformën e shkollës, libra, lapsa dhe çantat shkollore. Nuk besoj se babai ka të holla t'i paguajë të gjitha këto. »

5. «Prindërit e mi thonë: Vajzat duhet të punojnë në shtëpi e jo të shkojnë në shkollë. Ata thonë se pas pak hohe duhet të martohem e kështu shpenzimet për shkollimin tim do të shkonin kot e do të përfitonë vetëm burri im. »

6. “Unë kam një motër dhe dy vëllezërit. Prindërit e mi arrijnë vetëm dy prej nesh të na shkollojnë e këta janë vëllezërit e mi. Motra ime dhe unë do të mbetemi në shtëpi. ”

7. „Në fshatin tim nuk ka shkollë. Fshati tjetër ka, por ai është 8 km larg. Kjo është shumë larg për të udhëtuar çdo ditë. Ah, sikur edhe fshati im të kishte një shkollë!“

Me arsimim luftojmë varfërinë, sëmundjet, vdekshmërinë e hershme, forcojmë demokracinë, përkrahim barazinë e gjinive etj.

1. Punë në grupe: Mundësi për shkollim

Ndahuni n̄e grupe pune 3-4 nxënës/e.

Nga përvoja juaj dhe shembujt e dhënë më lart bisedoni e shkruani në pllakat:

Cilat janë arsyet që jo të gjithë fëmijët kanë mundësi të shkojnë në shkollë?

Pastaj krahasoni rezultatet e punës së grupeve. Konstatoni ngjashmëritë dhe dallimet dhe arsyetoni ato. Në fund, punojeni një pllakat të përbashkët.

2. Pyetni prindërit, gjyshen dhe gjyshin se si ishin mundësítë e tyre për shkollim. Shkruani çka mësuat!

3. Cilat janë arsyet që sidomos vajzat nuk mund të shkojnë në shkollë në disa vende?

4. Diskutoni dhe përmblidhni pesë (ose më shumë) argumente të fuqishme pse thuhet që arsimi është një armë e fortë dhe shumë e rëndësishme!

- 1) _____
 - 2) _____
 - 3) _____
 - 4) _____
 - 5) _____

FAMILJA E TEONËS

Një ditë mësuesi i gjuhës amtare shënoi në tabelë titullin *Integrimi, asimilimi dhe izolimi në shoqërinë e vendit*. Filloi t'i pyeste nxënësit e nxënëset se kur kanë ardhur në mërgim, si kanë ardhur në këtë vend ku jetojnë tash e shkollohen, me kë shoqërohen dhe si ndihen ata dhe prindërit e tyre. Nxënësit e nxënëset e klasave më të ulëta thanë se kishin lindur në mërgim, por familjet e tyre kishin ardhur para dhe gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, para viteve 1997-99. Saranda nga Tetova tha se ajo kishte ardhur këtu së bashku me nënën, vëllanë dhe motrën për t'iu bashkuar babait, i cili vite më parë kishte ardhur te babai i vet, pra gjyshi, për të punuar dhe për të mbajtur familjen e gjerë në Tetovë. Edhe Kosovarja tha se babi i saj kishte lënë Shqipërinë në vitet e para të demokracisë 1990-92, kurse ajo iu kishte bashkangjitur babait së bashku me nënën dhe vëllanë në vitin e Pavarësisë së Kosovës, në vitin 2008. Interesant ishte rrëfimi i Teonës, i cili u bëri përshtypje të mëdha të gjithë nxënësve të klasës dhe ishte një histori në vete:

«Ishte viti 1997. Unë isha gjashtëvjeçare. Një mëngjes babai na tha të bëhem i gati se do të shkojmë diku. Rrugës për në stacionin e autobusëve dëgjoheshin krisma të pushkëve dhe automatikëve, të luftëtarëve të lirisë. Hipëm në autobus ku kishte edhe njerëz të tjerë. U nisëm në drejtim të paditur për mua dhe vëllanë tim, foshnjë. Pas shumë orë udhëtimi, në mbrëmje vonë arritëm në një qytet të vogël, që atëherë nuk e dija si quhej, por tash e di se më ka treguar babai. Pastaj e di se kemi ecur disa orë në këmbë natën, nëpër një mal të dendur dhe nëpër një mot të ftohtë e me shi. Me ne ishin dhe disa familje të tjera shqiptare. Duke ecur nëpër terr, u rrëzova dhe fillova të qaja. Një dorë ma mbylli gojën. E njoha atë dorë vetëm atëherë kur dëgjova zërin e babait që më tha: Mos qaj! Edhe këtë veprim të babait atëherë nuk e kuptova, por sot e di, për të mos na dëgjuar rojet e kufirit, se po kalonim ilegalisht. Diku para mëngjesit arritëm në një qytet të vogël, por të pastër e të rregulluar mirë. Hipëm në një automobil dhe arritëm në një qytet të madh. Të lodhur e të rraskapitur nga rruga e gjatë dhe e mundimshme shkuam në një ndërtesë, ku pritëm disa orë në rend për të marrë, si i dëgjoja prindërit, azil. Pasi mbaruam punë, na dërguan në një ndërtesë, ku gjetëm edhe shumë familje e fëmijë nga Kosova, Shqipëria e shumë shtete të tjera të Evropës dhe kontinenteve të tjera. Pas dy dite kur u zgjova në mëngjes, babai nuk ishte në banesë. Ai ishte kthyer në Kosovë, për t'iu bashkangjitur luftëtarëve të lirisë. Në fillim e patëm të vështirë, se nuk e njihnim gjuhën e vendit, ishim shumë nacionalitete me *kulturë, tradita e gjuhë të ndryshme*. Më vonë filluam të mësohemi e të bëhem si një familje. Pas çlirimtës së Kosovës, në qershor të vitit 1999, babai u kthye te ne. U regjistruan në kursin e gjuhës së vendit së bashku me nënën. Për një kohë të shkurtër ata mësuant mirë gjuhën. Shpeshherë në mbrëmje mësonim së bashku me prindërit. Babai gjeti punë dhe u vendosëm në një banesë dydhomëshe. Në hyrjen tonë banonte edhe një familje vendase, me të cilën shoqëroheshim shumë dhe shkëmbenim vizita. Edhe unë zura shoqe vendase. Shoqe zura edhe nga nacionalitetet e tjera që jetojnë këtu. Kur e kuptova se në qytet kishte edhe shkollë shqipe, u regjistrova dhe tash marrë pjesë me kënaqësi në mësimin e gjuhës amtare. Shkolla shqipe më ka ndihmuar shumë ta mësoj edhe gjuhën e vendit. Në shkollë gjeta shumë shoqe shqiptare,

që edhe sot shoqërohem me to. Tash i di të dy gjuhët në nivel të njëjtë. Jam përshtatur plotësisht, saqë vendi ku unë jetoj më është bërë edhe *atdheu im i dytë*. Pra e ndiej veten *të integruar* mirë në shoqërinë e vendit e jo edhe *të asimiluar*, e as të *izoluar*, si janë disa shokë e shoqe, jo vetëm shqiptarë por edhe të nacionaliteteve të tjera. »

Detyra

- 1. Diskutoni në grup arsyet pse disa njerëz ia arrijnë qëllimit të integrimit (duke ruajtur edhe kulturën e tyre amtare), kurse të tjerët bëhen viktima ose të asimilimit ose të izolimit! Shënoni rezultatet e diskutimit dhe paraqitini para klasës!**
- 2. Në një fletë A4, bëje një trekëndësh me cepat integrim-asimilim-izolim. Shëno me pikat ku përafërsisht qëndron ti dhe ku disa persona të tjerë që i njeh (shkruaj emrat e tyre pranë pikave përkatëse). Tregoji fletën shokëve/shoqeve dhe diskutojini fletët e ndryshme!**
- 3. Lexo listën vijuese me thënie për qëndrime të ndryshme. Shëno pas secilës fjali se a kemi të bëjmë më shumë me integrim (= Int.), me asimilim (= A) ose me izolim (= Iz.).**

- Kur e di gjuhën e vendit dhe gjuhën amtare si duhet;
- Kur e di gjuhën e vet si duhet, kurse atë të vendit pak;
- Kur e di vetëm gjuhën e vendit;
- Kur ndihesh në vendin ku jeton si në Atdheun e të parëve të tu;
- Kur nuk ke fare shokë/ shoqe të vendit ku jeton;
- Kur lidh shoqëri vetëm me shokët/shoqet e vendit ku jeton;
- Kur luan e mëson me të gjithë moshatarët/moshataret e vet/a;
- Kur shoqërohet vetëm me shokët/shoqet e nacionalitetit të vet;
- Kur në ditëlindje fton vetëm shokët/ shoqet nga nacionaliteti i vet;
- Kur në ditëlindje fton shokët e shoqet vendase dhe të nacionaliteteve të tjera;
- Kur feston vetëm festat e veta fetare e nacionale;
- Kur merr pjesë e angazhohet vetëm në festat e vendit ku jeton;
- Kur angazhohet e jep kontributin e vet në shoqërinë e vendit;
- Kur dëgjon vetëm muzikën e vendit e të kombeve të tjera;
- Kur dëgjon vetëm muzikën e kombit të vet;
- Kur dëgjon muzikën kombëtare dhe atë të kombeve të tjera;
- Kur shikon vetëm programet televizive në gjuhën amtare;
- Kur shikon vetëm programet televizive në gjuhën e vendit;
- Kur shikon programet televizive në gjuhën e vendit dhe gjuhën amtare;
- Kur nuk ka dëshirë të vizitojë Atdheun e të afërmitt e vet.

KUSH ISHTE NËNA TEREZE

Kolë e Drane Bojaxhiu, të ardhur nga Prizreni në Shkup, lindën tre fëmijë. Vajzën e parë Agen, djalin Lazerin dhe, më 27. 10. 1910, fëmijën e tretë, vajzën Gonxhe. Babai Kola ishte tregtar i suksesshëm, kurse nëna Drane ishte një grua e dashur, e mençur dhe shumë e vyeshme.



Pas vdekjes së papritur të babait në vitin 1919, familja u gjend në situatë të vështirë ekonomike, duke e humbur edhe shtëpinë. Nëna Drane i rriti dhe i shkolloit tre fëmijët me vështirësi të mëdha. Edhe pse e varfër, ajo mundohej t'u ndihmonte fëmijëve të varfër të lagjes me ushqime e rroba. Fëmijët e vet e të lagjes e quanin «Nëna Loke».

Gonxhja në shkollë ishte nxënëse shumë e mirë. Kur ishte 12-vjeçare kishte tri dëshira: *të bëhej mësuese, të bëhej poete, të merrej me muzikë*. E ndikuar nga bamirësia e Nënës Loke, por edhe duke lexuar histori të shumta mbi varférinë në Indi, që ia jepte mësuesi i saj në shkollë, ajo pat thënë: *Unë dëshiroj kurdoherë t'u shërbejë të varfërve*.

Në moshën 18-vjeçare Gonxhja vendosi të bëhej motër përdëllastare. Udhëtoi për në Dublin të Irlandës. Pas dy muaj qëndrese, me anije udhëtoi për në Loreto të Indisë. Në vitin 1929 u bë mësuese e gjeografisë në shkollën e vajzave në Kalkutë.

Në vitin 1931, për nderim të motrës së nderit nga Avila e Spanjës me emrin Tereza, Gonxhja mori emrin e saj. Në vitin 1937 Nëna Tereze u bë drejtoreshë e shkollës ku punonte.

Duke parë çdo ditë njerëz të varfër e të sëmurë nëpër rrugët e Kalkutës, në vitin 1948 vendosi ta linte shkollën dhe t'i përkushtohej ndihmës së të varférve, të sëmurëve, të të braktisurve fëmijë e pleq. Për këtë qëllim themeloi Misionin e Motrave Bamirëse në Kalkutë. Misione të tilla u themeluan edhe në 115 shtete të botës, ku shërbejnë rreth 9000 motra përdëllastare.

Bija shqiptare, Nëna Tereze e gjithë botës, gjithë jetën e vet e shkrua në shërbim të të varférve, të sëmurëve e të braktisurve. Për këtë arsyе ajo u quajt edhe: „Nëna e bamirësisë“, „Nëna e dashurisë mes njerëzve“, „Nëna e të varférve“ etj.

Për veprën e saj bamirëse Nëna Tereze mori mirënjojje e çmime të shumta nga shumë shtete të botës. Shpërblimi më i madh është **Çmimi Nobël për Paqe**, i cili iu dha në vitin 1979.

Nëna Tereze vdiq me **05. 09. 1997**. Ajo u varros në Kalkutë të Indisë me nderime të mëdha ndërkombe të. Për meritat e jashtëzakonshme në lëmin e bamirësisë, për Nënën Tereze janë shkruar mijëra artikuj e dhjetëra libra jo vetëm nga shqiptarët, por edhe nga shumë autorë të kombeve e të shteteve të botës. Shembulli i saj është shumë i veçantë, prandaj **ajo edhe u lumturua** nga Papa Gjon Pali i Dytë në vitin 2003.



1. Përsërisim! Përgjigjuni këtyre pyetjeve.

a) Cila ishte familja e Nënës Tereze? Nëna: _____ Babai: _____

Motra: _____ Vëllai: _____

b) Kur dhe ku u lind Gonxhe Bojaxhiu?

c) Me çka mendoi të merrej Gonxhja derisa ishte nxënëse 12-vjeçare?

c) Kush ndikoi te Gonxhja t'i kushtohej bamirësisë?

d) Në cilën moshë u largua Gonxhja nga Shkupi dhe ku shkoi?

e) Në nderim të kujt Gonxhja mori emrin Nëna Tereze?

ë) Çka themeloi Nëna Tereze në Kalkutë?

f) Në sa shtete të botës vepron Misioni i Motrave Bamirëse?


g) Cili ishte çmimi më i madh që mori Nëna Tereze në vitin 1979?

gj) Kur vdiq dhe ku u varros Nëna Tereze?

h) Kur dhe nga kush u lumturua Nëna Tereze?

2. Shkruaj disa fjali për çka të bën përshtypje më së shumti Nëna Tereze!

3. Detyrë shtëpie: Kërkoni në internet ose në libra materiale shtesë për Nënën Tereze, sillini në shkollë dhe bëni një pllakat ose një referat për klasën tuaj!



Ibrahim Kodra,
Shqipëria fantastike



Adem Kastrati,
Pikture

Hazir Mehmeti, Nexhmije Thaçi–Mehmetaj, Rifat Hamiti
NJË BOTË PËR TË GJITHË
Fletore tematike - për nivelin e tretë

Botimi i parë

Botues:
Shtëpia botuese "DUKAGJINI" - Pejë

Për botuesin:
Agim Lluka

Redaktor teknik:
Lavdim Beqiri

Tirazhi: 5.000 kopje
Formati: 205x285

U shtyp në shkurt 2013
në shtypshkronjën "Dukagjini" - Pejë
www.dukagjinigroup.com

Katalogimi në botim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

37:008(=18)(076.1)

Mehmeti, Hazir

Një botë për të gjithë: fletore tematike për nivelit e tretë /
Hazir Mehmeti, Nexhmije Thaçi-Mehmetaj, Rifat Hamiti.
- Botim i parë. - Pejë: Dukagjini, 2013. - 56 f.: ilustr. me ngjyra; 29 cm.

1. Thaçi-Mehmetaj, Nexhmije 2. Hamiti, Rifat

ISBN 978-9951-05-262-7

*Lejohet për botim me vendim të Ministrisë së Arsimit,
të Shkencës dhe të Teknologjisë të Kosovës, nr 2-3774, të datës 17.10.2012*